

# Ndikimi i digjitalizimit të shërbimeve të gjendjes civile në të hyrat buxhetore të komunave



Ndikimi i digjitalizimit të  
shërbimeve të gjendjes civile në  
të hyrat buxhetore të komunave

Prill 2023

— **Përmbajtja**

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	4
Ndikimi i digjitalizimit në shërbimet që ofrojnë komunat	5
Të hyrat dhe shpenzimet e komunave nga ofrimi i shërbimeve administrative	6
Përdorimi i platformës e-Kosova për shërbime administrative	13
Përfundim	15

## Përmbledhje ekzekutive

Qeveria e Kosovës po synon të ulë barrën administrative duke digjitalizuar shërbimet dhe duke ulur koston që qytetarët duhet ta bartin për tërheqjen e këtyre shërbimeve.

Deri më tani, janë grumbulluar informata dhe disa shërbime janë ofruar përmes platformës elektronike e-Kosova. Gjatë vitit 2022, në kuadër të kësaj platforme, është përfshirë edhe ofrimi i një numri të shërbimeve nga sektori i gjendjes civile. Nga qershori deri në fund të dhjetorit të vitit 2022, nga kjo platformë, qytetarët kanë tërhequr 238,015 dokumente të gjendjes civile. Ndërsa në formë fizike, gjatë vitit 2022, qytetarët kanë tërhequr afro 2.2 milionë dokumente nga sektori i gjendjes civile në 38 komunat e Kosovës. Sipas kalkulimeve të Institutit GAP, qytetarëve pritet ti kursejnë mbi 1.5 milionë euro në vit nga tërheqja online e dokumenteve të gjendjes civile nga platforma e-Kosova. Ngjashëm, komunat priten t'i ulin shpenzimet e tyre të stafit, veçmas tek bashkësitë lokale, mbyllja dhe riformatimi i shumë prej të cilave është rekomanduar nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC). Aktualisht, në tërë territorin e Kosovës ekzistojnë 180 njësi administrative (bashkësi lokale) që ofrojnë nëntë dokumente të gjendjes civile, si: certifikata e lindjes, ekstrakti i lindjes, certifikatë e shtetësisë, certifikatë e martesës, certifikatë e vdekjes, certifikatë e vendbanimit, certifikatë e gjendjes martesore, deklaratë e bashkësisë familjare dhe vërtetim nga arkivi.

Dilema që e ka shoqëruar nismën e uljes së barrës administrative është nëse ky proces do të shoqërohet me humbje buxhetore, veçmas nga komunat, meqë të hyrat nga administrata konsiderohen dhe trajtohen si të hyra vetanake për nivelin lokal. Sipas kalkulimeve të Institutit GAP, të hyrat e 38 komunave në vitin 2022 nga lëshimi i dokumenteve dhe ofrimi i shërbimeve nga sektori i gjendjes civile ishin rreth 2.3 milionë euro, kurse shpenzimet rreth 2.2 milionë euro. Të hyrat totale ishin më të larta se shpenzimet kryesisht për shkak të komunave më të mëdha, meqë 20 nga 38 komuna kanë më shumë shpenzime se sa të hyra nga ky sektor. Konkretisht, Komuna e Prishtinës 69 mijë euro më shumë se shpenzime, ajo e Prizrenit ka gjeneruar 54 mijë euro më shumë, e Ferizajt 57 mijë euro më shumë, e Pejës 48 mijë euro më shumë, etj. Ndërkaq, komunat tjera, sikurse ajo e Vushtrrisë, ka gjeneruar të hyra nga ky sektor gjatë vitit 2022 në vlerë prej 73,573 euro, ndërsa për periudhën e njëjtë, shpenzimet kanë qenë 87,000 euro. Në anën tjetër, komuna e Skënderajt ka gjeneruar të hyra prej 55,389 euro, ndërsa kishte shpenzime prej 90,766 euro. Ngjashëm, komuna sikurse e Drenasit ka gjeneruar të hyra 53,604 euro, ndërsa ka pasur shpenzime prej 75,094 euro. Raporti mes të hyrave dhe shpenzimeve pritet të jetë më i zhdrejtë nga viti 2023 e tutje, në dëm të të hyrave të komunave, me rritjen e numrit të dokumenteve të tërhequra nga qytetarët përmes e-Kosovës.

Pjesëmarrja e të hyrave financiare nga shërbimet e gjendjes civile në të hyrat vetanake të komunave është e ulët. Në pjesën më të madhe të komunave, kjo pjesëmarrje është nga 1% deri në 4%. Andaj, ulja apo eliminimi i barrës administrative nuk pritet të ketë ndikim të madh në buxhetin e komunave. Nga të dhënat e pranuar nga komunat, del se nuk ekziston ndonjë lidhshmëri mes numrit të stafit në zyret e gjendjes civile nëpër komuna dhe numrit të banorëve në komunat përkatëse. Prishtina që zyrtarisht vlerësohet t'i ketë afro 220,000 banorë, ka të punësuar 39 zyrtarë apo një zyrtar/e për 5,641 banorë, ndërsa Skenderaj që vlerësohet t'i ketë 52,600 banorë ka të punësuar 17 zyrtarë apo një zyrtar/e për 3,094 banorë, apo Komuna e Klinës me 40,000 banorë ka të punësuar 15 zyrtarë apo një zyrtar/e për 2,667 banorë.

## Hyrje

Më 28 dhjetor 2022, Qeveria e Kosovës aprovoi Strategjinë e Reformës së Administratës Publike 2022–2027, si dokument kryesor në reformimin e administratës publike, dhe Planin e saj të veprimit për vitet 2022–2024.<sup>1</sup>

Një ndër katër objektivat e Strategjisë (objektivi i dytë) parasheh rritjen e cilësisë në ofrimin e shërbimeve administrative. Për arritjen e këtij objektivi, masat kryesore të reformës parashikojnë agjendën gjithëpërfshirëse të politikave për ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë kornizën legjislative të harmonizuar dhe qasjen koherente për thjeshtëzimin administrativ dhe heqjen e barrës administrative për qytetarët dhe bizneset.<sup>2</sup> Kësaj i ka paraprirë edhe aprovimi i Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022–2027, si dhe Plani i veprimit që bazohet në këtë program.<sup>3</sup>

Me barrë administrative nënkuptohet çdo procedurë që shkakton shpenzime shtesë për qytetarët dhe vonesa në kohë në marrjen e shërbimeve administrative. Barra administrative nuk lidhet domosdo vetëm me tarifën në ofrimin dhe marrjen e shërbimit, por nënkupton edhe shpejtësinë në marrjen e shërbimit, pa pasur nevojë për të vizituar komunën fizikisht.<sup>4</sup> Sipas Planit të veprimit të Programit për Zvogëlimin e Barrës Administrative parashihet që deri në vitin 2024, qytetarëve dhe bizneseve t'u kursehen së paku gjashtë milionë euro si rezultat i thjeshtëzimit dhe eliminimit të barrës administrative.

Parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative është parë i nevojshëm edhe si formë e parandalimit të korrupsionit dhe krijimit të një mjedisi më të mirë të bërit biznes. Barra administrative zakonisht shkaktohet nga procedurat e panevojshme, legjislacioni kontradiktor, zbatimi jo i duhur i legjislacionit, informacionet e paqarta, kapacitetet e mangëta për ofrim cilësor të shërbimeve, digjitalizimi i pamjaftueshëm dhe mungesa e ndërmarrjes së reformave në administratë.<sup>5</sup>

Format që vlerësohen përgjithësisht të suksesshme në ofrimin e shërbimeve në administratën publike janë ai 'një sportel për të gjitha shërbimet' ose forma online pa pasur nevojë të vizitave në sportelet e institucionit.<sup>6</sup> Institucionet duhet të sigurohen që asnjë organ i administratës publike nuk kërkon një informacion apo dokument nga qytetarët, të cilin të njëjtit e kanë dorëzuar më herët në administratë, ngase të dhënat do të integrohen në sistem dhe të njëjtat do të mund të përdoren në secilin rast. Aplikimi i plotë i këtij parimi sfidohet nga problemet teknologjike, profesionale, teknike, strukturore dhe ligjore.

Në dhjetor të vitit 2022, është krijuar Komisioni për Transformim Digjital<sup>7</sup> i cili është përgjegjës për të mbikëqyrur dhe për të siguruar mbarëvatjen e procesit të transformimit digjital, nisur nga planifikimet e vendosura në Strategjinë e Reformës së Administratës Publike në Kosovë 2022–2027.<sup>8</sup> Komisioni përbëhet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyra e Kryeministrit. Ky Komision do të shqyrtojë dhe miratojë prioritetet strategjike dhe iniciativat e politikave të reja

1 Zyra e Kryeministrit. Vendim nr 17/116. Datë 28.12.2022. Burimi: <https://bit.ly/3EsrxnG>

2 Zyra e Kryeministrit. Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2022–2027. Fq 39. Burimi: <https://bit.ly/3ksJN9L>

3 Zyra e Kryeministrit. Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022 -2027. Prill 2022.

Versioni i azhurnuar. Platforma e Konsultimeve Publike. Burimi: <https://bit.ly/3ZbcDu7>

4 Po aty, fq. 10–11.

5 Po aty.

6 Po aty, fq. 16.

7 Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. U mbajt takimi i parë i Komisionit për Transformim Digjital. 23 dhjetor 2022.

Burimi: <https://bit.ly/3RAdjqk>

8 Zyra e Kryeministrit. Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2022–2027. Fq 39. Burimi: <https://bit.ly/3ksJN9L>

të qeverisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit, do të rekomandojë politika që lehtësojnë dhe mundësojnë digjitalizimin, si dhe do të sigurojë koordinim ndër institucional në mes të nivelit qendror dhe lokal në projektet dhe çështjet që bien në fushën e digjitalizimit. Përveç kësaj, ka nisur procedura e plotësim/ndryshimit të Ligjit për gjendjen civile dhe Ligjit për vendbanimin<sup>9</sup> (sipas planit legjislativ, deri në muajin qershor 2023 parashihet që këto dy projektligje të kalojnë për votim në Qeveri; që i hap rrugën procedimit të tyre në Kuvend të Kosovës). Nevoja për t'i plotësuar/ndryshuar këto dy ligje buron nga parimi i digjitalizimit të shërbimeve dhe uljes së barrës administrative.<sup>10</sup>

Në këtë analizë, Institutit GAP tregon se si ndikohen komunat nga procesi i i uljes së barrës administrative dhe digjitalizimit të shërbimeve të gjendjes civile. Analiza nuk trajton të gjitha shërbimet administrative që ofrohen nga niveli lokal, si: licencim i shërbimeve, vërtetim prone, fletë poseduese, kopje e planit, pëlqim urbanistik, leje ndërtimi, legalizim, autorizim për shfrytëzim të pronës, hapësirës apo qirasë, etj. Analiza shfaq të hyrat dhe shpenzimet aktuale të komunave nga ofrimi i shërbimeve nga sektori i gjendjes civile, tarifat e aplikuar për këto dokumente, numri i dokumenteve që ato lëshojnë gjatë vitit, si dhe numri i dokumenteve të gjendjes civile që qytetarët kanë tërhequr përmes platformës elektronike e-Kosova. Kjo analizë është hartuar duke marrë për bazë dokumentet zyrtare për procesin e barrës administrative, procesin e digjitalizimit si dhe përmes një pyetësori janë pranuar të dhëna zyrtare nga 32 komuna. Bazuar në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumente publike, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit dhe nga Agjencia e Regjistrimit Civil kanë ofruar të dhëna për tërheqjen e dokumenteve të gjendjes civile përmes platformës e-Kosova dhe në formë fizike.<sup>11</sup>

## Ndikimi i digjitalizimit në shërbimet që ofrojnë komunat

Hapi i parë në pushtetin lokal në digjitalizimin e shërbimeve është bërë në vitin 2015, në Komunën e Prishtinës, kur është instaluar dhe ofruar mundësia e tërheqjes së disa prej dokumenteve të gjendjes civile edhe përmes sistemit të e-kiosqeve, pa pasur nevojë kështu që qytetarët t'i qasen fizikisht sportelit të komunës.<sup>12</sup> E-kiosqet i mundësuan qytetarëve që të shmangin radhët në sportele dhe të tërheqin dokumentet edhe pas orarit zyrtarë të punës, por sërish për tërheqjen e dokumenteve qytetarët duhej të parasqiteshin fizikisht.

Sipas Programit për Zvogëlimin e Barrës Administrative, e tërë barra administrative në shërbimet që ofrojnë komunat shkaktohet nga legjislacioni i administratës qendrore, përveç atyre shërbimeve që derivojnë nga kompetencat vetanake të komunave.<sup>13</sup>

Më 9 qershor 2022, Qeveria lansoi pesë shërbime të reja elektronike të cilat mund të nxirren përmes portalit e-Kosova: certifikata e lindjes, ekstrakti i lindjes, certifikata e martesës, certifikata e vdekjes dhe ekstrakti për anëtar të familjes.<sup>14</sup> Platforma e-Kosova është platformë shtetërore ku shërbimet publike që ofrohen në zyrat dhe

9 Intervistë, Erdon Arifaj. Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit të Gjendjes Civile në Agjencinë e Regjistrimit Civil. Datë 03.03.2023. Prishtinë.

10 Erdon Arifaj. Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit të Gjendjes Civile në Agjencinë e Regjistrimit Civil. Datë 03.03.2023.

11 Komunat që nuk janë të përfshira në këtë analizë janë: Leposaviqi, Zubin Potoku, Zveçani, Mitrovica e Veriut, Klllokoti dhe Mamusha.

12 Institutit GAP. Ngecjet e komunave në funksionalizimin e kiosqeve elektronike për ofrimin e shërbimeve administrative. Korrik 2019. Fq 3. Burimi: <https://bit.ly/2IVxlRx>

13 Zyra e Kryeministrit. Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022 -2027. Prill 2022. Versioni i azhurnuar. Platforma e Konsultimeve Publike. Burimi: <https://bit.ly/3ZbcDu7>

14 Zyra e Kryeministrit. Kryeministri Kurti mori pjesë në lansimin e shërbimeve të reja elektronike në portalin e-Kosova. 9 qershor 2022. Burimi: <https://bit.ly/3Z9Z51Z>

sportelet e institucioneve publike synohen të ofrohen në mënyrë elektronike.<sup>15</sup> Ky konsiderohet të jetë hapi i parë në digjitalizimin e shërbimeve administrative, i cili ndikon edhe në shërbimet administrative të komunave.

Krahas kësaj, në shtator të vitit 2022, në kuadër të platformës e-Kosova është integruar edhe vegëza e platformës "e-Komuna".<sup>16</sup> Deri në muajin shkurt 2023, në kuadër të kësaj vegëze janë përfshirë informatat për shërbimet që mund të tërhiqen nga Komuna e Prizrenit dhe ajo e Lipjanit. Me Planin e veprimit të Programit për Zvogëlimin e Barrës Administrative parashihet që gjatë vitit 2023, kjo platformë të plotësohet me informata dhe shërbime edhe për komunat tjera. Plani i veprimit po ashtu parasheh që në tri vitet e para të thjeshtëzohen shërbimet në së paku nëntë komuna.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka hartuar pikat e referencës për digjitalizim të shërbimeve në nivel lokal dhe sipas planifikimeve parashihet që këto shërbime të digjitalizohen në tërësi deri në fund të vitit 2025.<sup>17</sup> Bazuar në referencat e vendosura, parashihet monitorimi digjital i organeve komunale, rritja e ndërveprimit me qytetarë dhe përfaqësues të zgjedhur lokal, monitorimi dhe prezantimi në kohë reale i të gjitha investimeve, buxhetit dhe të hyrave vetanake komunale, ofrimi i shërbimeve administrative për qytetarë dhe biznese online dhe përmes postës, planet urbanistike të lagjeve, lejet dhe kushtet ndërtimore, prezantimi i procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale në kohë reale si dhe paraqitja në mënyrë të vizualizuar të procesit të performancës komunale.<sup>18</sup>

### — Të hyrat dhe shpenzimet e komunave nga ofrimi i shërbimeve administrative

Shërbimet administrative që ofrohen nga komunat nga sektori i gjendjes civile nuk janë pjesë e kompetencave vetanake të komunave. Kjo detyrë mbulohet si përgjegjësi e deleguar nga niveli qendror, por që administrohet nga niveli lokal. Duke përjashtuar vërtetimin mbi vendbanimin ose dëshminë e ndryshimit të vendbanimit (lagjës, zonës), dokumentet e tjera nuk përmbajnë shenjë dalluese të komunave, por vetëm stemën e shtetit.

Të hyrat që realizohen nga lëshimi i këtyre dokumenteve trajtohen si të hyra vetanake të komunave. Tarifat e këtyre dokumenteve vendosen nga rregullorja komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale. Prodhimi i një dokumenti të gjendjes civile shtetit të Kosovës i kushton 0.04 euro.<sup>19</sup>

Në Tabelën 1 janë paraqitur të gjitha dokumentet e gjendjes civile që mund të merren në komuna si dhe kosto e tyre për qytetarë.

15 <https://ekosova.rks-gov.net/>

16 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Lansohet platforma E-komuna. 05/07/2022. Burimi: <https://bit.ly/3WJ8GuQ>

17 Ibid. Fq 4.

18 Ibid. Fq 7.

19 Intervistë me Erdon Arifaj. Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit të Gjendjes Civile në Agjencinë e Regjistrimit Civil. Datë 03.03.2023.

**Tabela 1.** Lista e dokumenteve që ofrohen nga komunat nëpërmjet zyrës së gjendjes civile dhe kosto e tyre për qytetarë

Dokumentet që lëshohen nga sektori i gjendjes civile në komuna	Çmimi (€)
Certifikata e lindjes	1
Ekstrakti i lindjes	1
Certifikata e shtetësisë	2
Certifikata e martesës	2
Certifikata e vdekjes	5
Certifikata e vendbanimit	1
Certifikata e gjendjes martesore	2
Deklarata e bashkësisë familjare	1
Vërtetim nga arkivi i gjendjes civile	1
<b>Shërbimet nga sektori i gjendjes civile në komuna</b>	
Lidhja e martesës ku njëri nga partnerët është shtetas i huaj	10 deri 20
Aplikim për korigjimin e emrit personal	2
Për ceremoninë e martesës	15
Për ceremoninë e kurorëzimit jashtë objektit të komunës	30 deri 100
Vendim për ndryshimin e vendbanimit	5

Burimi: Instituti GAP, bazuar në rregulloret për gjopa dhe tarifa komunale.

Sipas Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, kur pagesa për shërbimet administrative është e parashikuar me ligj, ajo nuk mund të jetë më e madhe se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e llojit përkatës të procedurës administrative.<sup>20</sup> Zbatimi i këtij parimi ligjor, sipas Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative, do të sjellë edhe ulje të të hyrave nga pagesa për marrjen e shërbimeve.

Sipas vlerësimeve të Qeverisë, të hyrat buxhetore të humbura pritet të jenë dy milionë euro për vit, gjersa deri në fund të zbatimit të Programit në vitin 2027, të hyrat vetanake të komunave mund të zvogëlohen deri në 10 milionë euro.<sup>21</sup>

Të gjitha komunat e Kosovës në baza tremujore pranojnë kontigjente materiale nga Ministria e Punëve të Brendshme të cilat pastaj shfrytëzohen për të ofruar shërbime administrative. Kjo llogaritet t'i kursejë komunat nga shpenzimet e mëdha administrative.<sup>22</sup> Por, edhe përkundër kësaj, janë disa materiale tjera (si ngjyra, blerja e printerëve, kompjuterëve, lapsave) të cilat kontraktohen nga komunat gjatë procesit të ofrimit të shërbimeve administrative.

Mundësia që qytetarët t'i marrin shërbimet edhe online do të mënjanonte shpenzimet shtesë administrative, do të ulte numrin e zyrtarëve që angazhohen në zyret e gjendjes civile, e për rrjedhojë do të ulte shumën e pagave që institucioni dedikon, po ashtu do të përshpejtonte kohën dhe do të thjeshtëzonte procedurat. Konkretisht, në rast se supozohet se 70% e qytetarëve do të fillojnë

20 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative. Neni 12. Burimi: <https://bit.ly/3kseVGn>


21 Zyra e Kryeministrit. Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022 -2027. Plani i veprimit. Fq 2 & 4. Prill 2022. Versioni i azhurnuar. Platforma e Konsultimeve Publike. Burimi: <https://bit.ly/3ZbcDu7>

22 Erdon Arifaj. Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit të Gjendjes Civile në Agjencinë e Regjistrimit Civil. Datë 03.03.2023.

t'i tërheqin dokumentet e gjendjes civile online dhe pa ndonjë tarifë të shërbimit, dhe një pjesëmarrje e të hyrave të sëlilës komunë nga lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile në raport me ofrimin e shërbimeve në nivelin prej 90%, atëherë del se qytetarëve brenda një viti do t'u kursehen mbi 1.5 milionë euro.

Ulja e barrës administrative nuk pritet të ketë ndikim të madh në buxhetin e komunave. Pjesëmarrja e të hyrave nga shërbimet e zyreve të gjendjes civile në të hyrat vetanake komunale është e ulët. Nga 32 komunat e analizuar, kjo pjesëmarrje tek shumica e komunave është më e ulët se 4%.

**Figura 1.** Përqindja e pjesëmarrjes së arkëtimit të mjeteve nga të hyrat e realizuara nga sektori i gjendjes civile si përqindje e të hyrave vetanake



Gjatë vitit 2022, të gjitha komunat kanë lëshuar mbi 2.2 milionë dokumente të ndryshme të gjendjes civile në formë fizike apo nëpërmjet qasjes së qytetarëve nëpërmjet sportele komunale.<sup>23</sup> Vlenë të theksohet, se për një numër të theksuar të dokumenteve të lëshuara nga komunat, nuk aplikohet tarifë. Konkretisht, për shërbimet administrative nga sektori i gjendjes civile janë të liruar veteranët e luftës, familjet e dëshmorëve, rastet sociale dhe rastet e dëshmuara të personave që vuajnë nga semundjet e rënda.


<sup>23</sup> Lista e dokumenteve të lëshuara nga sektorët e gjendjes civile nëpër komuna. Kërkesë për qasje në dokumente publike nga Instituti GAP. Aprovuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil. 02.03.2023.



Gjatë 2022 janë lëshuar 927,614 dokumente për përdorim të brendshëm dhe 1,236,938 për përdorim të jashtëm. Dokumente për përdorim të brendshëm janë lëshime të dokumenteve të gjendjes civile që lëshohen pa ngjyrë dhe pa elemente të sigurisë së dokumentit. Zakonisht perdoren për shkolla, shëndetësi, aplikime për punë, regjistrim në çerdhe dhe shëbime të ngjajshme. Kurse, për përdorim të jashtëm janë lëshime të dokumenteve të gjendjes civile që perdoren për aplikim nëpër ambasada dhe të cilat dokumente kanë gjitha karakteristikat e sigurisë.


**Figura 2.** Numri i dokumenteve që janë lëshuar gjatë vitit 2022 në të gjitha komunat e Kosovës përmes formës fizike të qasjes (për përdorim të brendshëm)

Burimi: ARC.



**Figura 3.** Numri i dokumenteve që janë lëshuar gjatë vitit 2022 në të gjitha komunat e Kosovës përmes formës fizike të qasjes (për përdorim të jashtëm)


Burimi: ARC



Bazuar në tarifatat, dokumentet e gjendjes civile të ndara si të brendshme dhe të jashtme nuk kanë ndonjë dallim.

Nga të dhënat e pranuar nga komunat, del se nuk ekziston ndonjë lidhshmëri mes numrit të stafit në zyrat e ofrimit nëpër komuna dhe numrit të banorëve në komunat përkatëse. Prishtina që zyrtarisht vlerësohet t'i ketë afro 220,000 banorë, ka të punësuar 39 zyrtarë apo një zyrtar/e për 5,641 banorë, ndërsa Skenderaj që vlerësohet t'i ketë 52,600 banorë ka të punësuar 17 zyrtarë apo një zyrtar/e për 3,094 banorë, apo Komuna e Klinës me 40,000 banorë ka të punësuar 15 zyrtarë apo një zyrtar/e për 2,667 banorë.

**Figura 4.** Numri i zyrtarëve të punësuar në zyrat e gjendjes civile në 32 komuna, krahas numrit të popullsisë (2022)



Burimi: Të dhëna të pranuar përmes të drejtës për qasje në të dhëna publike sipas komunave përkatëse gjatë 2022.

Nisur nga shuma e pagave për zyrtarët komunalë zyreve të gjendjes civile, vërehet mos standardizim nga komuna në komunë. Për shembull, nga 32 komunat e analizuara, pas Prishtinës për numrin me të lartë të zyrtarëve të punësuar në këto zyre vjen Skënderaj me gjithsej 17 zyrtarë, por shikuar nga shuma vjetore e pagave të ofruara, kjo komunë del e treta pas Podujevës që ka 15 zyrtarë të punësuar. Më shumë shpenzime për paga ka Komuna e Dragashit me gjithsej nëntë zyrtarë të punësuar, krahasur me Komunën e Lipjanit që ka 10 zyrtarë të punësuar.<sup>24</sup>

**Tabela 2.** Shuma e të hyrave dhe shpenzimeve nga ofrimi i shërbimeve administrative nga sektori i gjendjes civile në dhjetë komuna gjatë 2022

Komuna	■ Të hyrat	■ Shpenzimet
Prishtinë	289,191 €	220,500 €
Prizren	244,939 €	191,133 €
Gjilan	166,420 €	118,671 €
Pejë	159,915 €	112,165 €
Ferizaj	138,385 €	81,420 €
Gjakovë	128,695 €	96,405 €
Mitrovicë e Jugut	100,369 €	89,818 €
Podujeva	94,141 €	95,941 €
Malishevë	82,847 €	70,485 €
Vushtrri	73,573 €	87,000 €
Suharekë	73,287 €	60,484 €
Rahovec	70,000 €	65,764 €
Istog	66,176 €	39,128 €
Lipjan	58,222 €	58,082 €
Skenderaj	55,389 €	90,766 €
Drenas	53,604 €	75,094 €
Viti	50,415 €	61,552 €
Fushë Kosovë	46,743 €	49,170 €
Deçan	40,482 €	88,799 €
Klinë	38,302 €	58,867 €
Dragash	37,000 €	52,000 €
Kamenicë	36,306 €	45,862 €
Shtime	33,481 €	23,331 €
Obiliq	28,026 €	35,352 €
Kaçanik	25,581 €	44,733 €
Gracanicë	22,182 €	5,613 €
Mitrovicë e Veriut	20,492 €	5,613 €
Novoberda	15,171 €	2,204 €
Junik	9,682 €	15,744 €

<sup>24</sup> Paga mesatare mujore në këtë sektor të administratës del të jetë 370 euro, në disa komuna kjo shkon deri në 420 euro.

Komuna	■ Të hyrat	■ Shpenzimet
Shtërpcë	8,094 €	20,670 €
Mamushë	7,758 €	15,744 €
Ranillug	3,282 €	12,610 €
Kllokot	3,093 €	12,610 €
Zveçan	2,859 €	2,204 €
Hani i Elezit	2,500 €	14,490 €
Zubin Potok	2,458 €	15,744 €
Partesh	2,139 €	8,890 €
Leposaviç	2,012 €	5,613 €

Burimi: Të dhëna të pranura përmes të drejtës për qasje në të dhëna publike sipas komunave përkatëse, krahasim i bërë nga Instituti GAP.<sup>25</sup>

### — Përdorimi i platformës e-Kosova për shërbime administrative


Nga fillimi i muajit qershor 2022, në kuadër të platformës e-Kosova janë përfshirë dhe i është mundësuar qasja qytetarëve që t'i tërheqin në formën online një numër të dokumenteve të gjendjes civile si certifikata e lindjes, ekstrakti i lindjes, certifikatën e martesës, ekstrakti i gjendjes familjare, dhe certifikata e vdekjes. Tri ditë pas lansimit të kësaj mundësie, në këtë formë janë tërhequr mbi 20 mijë dokumente, ndërsa deri në fund të vitit janë tërhequr 238,015 dokumente. Numri më i madh i tyre është tërhequr nga qytetarët e Prishtinës, pastaj Prizrenit, Ferizajt, Gjilanit dhe Fushë Kosovës.<sup>26</sup>

Mundësia online, përveç që ndikon në kursimet financiare dhe të kohës për qytetarët, njëherazi mundëson marrjen e shërbimeve edhe jashtë orarit të punës së administratës, të shtunave dhe të dielave, shmang radhët pranë sporteleve të komunave dhe u mundëson komunave që të zvogëlojnë numrin e punonjësve për shërbime administrative apo t'i zhvendosin disa nga ta, të cilët nuk ofrojnë shërbime të gjendjes civile, në departamente tjera.

25 Për komunat të cilat nuk kanë dërguar të dhëna, të hyrat janë llogaritur bazuar në të dhënat e dërguara nga ARC rreth numrit të dokumenteve të lëshuara nga komunat gjatë vitit 2022 ose janë supozuar të jenë të njëjta me komunat me madhësi të ngjashme të popullsisë. Ndërkaq, shpenzimet e këtyrve gjashtë komunave janë supozuar sikur të jenë të njëjta me ato të komunave të ngjashme me to për numri i popullsisë. Kurse, tek komunat të cilat kanë dërguar të dhëna, në shpenzime janë përfshirë pagat mujore/vjetore për të punësuarit në sektorin e gjendjes civile dhe shpenzimet operative si: ngjyra, blerja e paisjeve si kompjuter, printer dhe inventarizim. Në shpenzime nuk përfshihen edhe shpenzimet e komunalive si rryma, uji, telefoni, interneti që përdoren nga ana e bashkësive lokale ku ofrohen edhe një numër i shërbimeve të gjendjes civile.

26 Agjencia e Shoqërisë dhe Informacionit. Pasqyra e përdorimit të platformës e-Kosova për periudhën qershor-dhjetor 2022. Kërkesë nga Instituti GAP për qasje në të dhëna publike, shkurt 2023.


**Figura 5.** Numri i dokumenteve të gjendjes civile të tërhequra nga platforma e-Kosova sipas komunave gjatë periudhës qershor-dhjetor 2022



Burimi: Të dhëna të pranuar përmes të drejtës për qasje në të dhëna publike nga Agjencia e Shoqërisë dhe Informacionit.

Nga natyra e dokumenteve të tërhequra nga qytetarët del se numri më i madh i tyre i janë certifikata të lindjes. Në sportelet e komunës ky shërbim ofrohet duke u kërkuar 1 euro për dokument, ndërsa nga platforma e-Kosova tërhiqet brenda pak sekondave dhe nuk kërkohet ndonjë pagesë.

**Figura 6.** Numri i dokumenteve të gjendjes civile të tërhequra nga platforma E-Kosova sipas llojit të dokumentit nga qershori deri në dhjetor 2022



Burimi: Të dhëna të pranuar përmes të drejtës për qasje në të dhëna publike nga Agjencia e Shoqërisë dhe Informacionit.

## Përfundim

Reforma e administratës publike ka qenë dhe mbetet një proces i ngadalshëm. Institucionet publike nuk kanë shfrytëzuar përparësitë që ofron teknologjia dhe interneti në ofrimin e shërbimeve në formë digjitale. Edhe më tej qytetarët obligohen që për kryerjen e shërbimeve në institucione publike të grumbullojnë vetë dokumentet që gjenden në pronësi të institucioneve publike. Kjo shkakton shpenzime të panevojshme, procedura të stërzgjatura dhe humbje kohe.

Së fundmi Qeveria ka filluar procesin e eliminimit të barrës administrative, apo eliminimin e procedurave që shkaktojnë vonesa dhe shpenzime me rastin e marrjes së shërbimeve administrative. Barra administrative zakonisht shkaktohet nga procedurat e panevojshme, legjislacioni kontradiktor, zbatimi jo i duhur i legjislacionit, informacionet e paqarta, kapacitetet e mangëta për ofrim cilësor të shërbimeve, digjitalizimi i pamjaftueshëm dhe mungesa e ndërmarrjes së reformave në administratë.

Disa nga dokumentet e gjendjes civile kanë filluar të ofrohen në formë elektronike nga qershori 2022 në platformën e-Kosova. Nga qershori 2022 deri në fund të vitit 2022 përmes platformës e-Kosova janë tërhequr 238,015 dokumente. Ndërsa në formë fizike, në 38 komuna gjatë vitit 2022 kanë tërhequr mbi 2.2 milionë dokumente nga sektori i gjendjes civile.

Nga lëshimi i dokumenteve dhe ofrimi shërbimeve nga sektori i gjendjes civile, komunat aktualisht gjenerojnë rreth 2.6 milionë euro të hyra, ndërkaq shpenzime janë rreth 2.1 milionë euro. Përveç disa komunave të mëdha, shumica nga komunat kanë ose të hyra të njëjta me shpenzimet, apo shpenzime më të larta se të hyrat. Raporti i zhdrejtë mes të hyrave dhe shpenzimeve, në dëm të të hyrave pritet të jetë më i theksuar gjatë vitit 2023, kur qytetarët pritet të marrin çdo herë e më shumë shërbime nga platforma e-Kosova.

Mundësia e marrjes së dokumenteve në formë digjitale, ndikon në kursime financiare për qytetarët, por edhe kursen kohën e tyre për të marrë shërbime nga sektori i gjendjes civile. Konkretisht, sipas kalkulimeve të Institutit GAP, nga tërheqja online e dokumenteve të gjendjes civile nga platforma e-Kosova, qytetarët pritet të kursejnë mbi 1.5 milionë euro në vit.

Nga kjo analizë është dokumentuar se heqja e kostos që u ngarkohet qytetarëve për marrjen e shërbimeve administrative nga sektori i gjendjes civile nuk pritet të ketë ndikim të madh në buxhetin e komunave. Në pjesën më të madhe të komunave të analizuara kjo pjesëmarrje është nga 1% deri në 4%.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)



Instituti GAP mbështetet nga:



Rockefeller  
Brothers Fund


Philanthropy for an Interdependent World

Ky projekt është mbështetur nga



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



Ndikimi i digjitalizimit të  
shërbimeve të gjendjes civile në të  
hyrat buxhetore të komunave